

E mitura në Vushtrri kapet me foto të armës në telefon – Policia po heton rrethanat e rastit



04/10/2025 10:25

f

tw

link

Gjatë hetimeve për një rast tjetër penal në Vushtrri, autoritetet kanë zbuluar një element shtesë që mund të përbëjë vepër penale.

Gjatë intervistimit të një të dyshuareje të mitur, femër kosovare, në lidhje me një rast të dhunimit, është hasur një fotografi në telefonin e saj ku ajo shihet duke mbajtur një armë, raporton [lajmi.net](#)

Ngjarja ka ndodhur më 3 tetor rreth orës 15:00. Gjatë kontrollit të telefonit të saj, si pjesë e procedurës hetimore, hetuesit kanë gjetur imazhin që ngriti dyshime për mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve.

E mitura është marrë në pyetje në prani të prindit dhe avokatit mbrojtës, por ka vendosur të mbrohet në heshtje.

Me vendim të Prokurorit të Shtetit, rasti është iniciuar dhe do të trajtohet në procedurë të rregullt, ndërsa hetimet janë ende në vazhdim./[Lajmi.net](#)/

LAJME TË FUNDIT

- 

'Miq të e Amerikës' për iniciativën e senatorëve amerikan:...
- 

Liverpool nis të numërojë humbjet, jo pikët –...
- 

Ndërsa flitet për paqe, Izraeli vret 55 palestinezë në një ditë të vetme
- 

Aktakuzat në mungesë për krime lufte, drojë se...

Artikuj të ngjashëm



October 4, 2025
'Miq të e Amerikës' për iniciativën e senatorëve amerikan: Qëndrim i drejtë...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
B.r. Zenel Salihu nr. 28, zyryja nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

- Fact-Checking Policy

Ethics Policy

Corrections Policy

Ownership & Funding Information

Editorial Team Information